



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:241593

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474102

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.822/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, sipas Gjyqtarit i vetëm gjykues Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh. K., për shkak të veprës penale “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PP/II Nr. 1807/21 të dt. 26.10.2021, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor të mbajtur me dt. 06.03.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Xh. K., me dt.06.03.2024 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 19.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Xh. K., i lindur me dt..... në Pejë, ku edhe banon në rr. A. Gj. 39, i biri i A.dhe nënës I., e gjinisë N., i pa punë-pensioner, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Konform nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja së:

Në kohë të panjohur e në vazhdimësi gjer me dt. 13.03.2021 në rr. A. Gj. në K.P. përmes mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të

kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që i pandehuri në shtëpinë e tij në adresën e lartcekur, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar është kyqur ne KPO me kabull 3x2.5 jashtë pikës matëse (njehsorit elektrik), ashtu që ne mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energji elektrike me aparat të caktuar dhe me këtë kompaninë KEDS e dëmton në vlerë prej 265.42€,

- me çka kishte për të kryer veprën penale “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së..

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm me dt. 26.10.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II Nr. 1807/21, kundër të pandehurit Xh. K., për shkak të veprës penale “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor me dt. 28.02.2024 si dhe seanca e fundit me dt. 06.03.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit Xh. K. si dhe dëshmitarit B. K. e në mungesë të përfaqësuesit i të dëmtuarës KEDS.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar të dëshmitaret A. E., R. R. dhe B. K. ka administruar provat materiale – formale të propozuara nga ana e Prokurorit të Shtetit në aktakuze si dhe është dhënë mbrojtja e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Pas administrimit të provave materiale dhe personale gjate këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor nuk u vërtetua me asnjë provë se këtu i akuzuari Xh. K. është kryes i veprës penale vjedhja e shërbeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e kjo nga fakti se pas dëgjimit të dëshmitarit B. K. nga Pejë, i njëjti e pranoj në tërësi se e ka kryer veprën penale e cila të pandehurit Xh. i vihet në barrë, e i cili theksoj se të pandehurin Xh. e ka baba, jetojnë në të njëjtën shtëpi, në shtëpi ka vetëm një njësor elektrik, babai i tij këtu i pandehuri Xh., jeton kohë pas kohe në shtëpinë që posedojnë në Pejë, sepse i njëjti jeton edhe në Gjermani, e ndër të tjera na shpjegoj se personalisht ka paguar

një person që ti bë lidhjen jashtë pikës matëse, duke u kyçur në KPO n ë kabull 3x2.5, me arsyetimin se i njëjti nuk kishte të ardhura që ta paguante rrymën e shpenzuar ku për pasojë dhe e kishim shkyçur nga rryma, ashtu që i njëjti, me qelli të siguroj energjinë elektrike në shtëpi, kishte bërë lidhjen pa autorizuar të përshkruar si më lart. Andaj nga të sipërshënuarat e vërtetuara, konform nënti 51 të KPPRK-së, tërhiqemi nga ndjekja penale kundre të pandehurit Xh. K..

Andaj, meqenëse Prokurori i Shtetit hoqi dore nga aktakuza PP/II Nr. 1807/21 të dt. 26.10.2021, dhe nga ndjekja penale ndaj të pandehurit Xh. K. e duke pas parasysh nenin 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së¹ si dhe faktin së tërheqja e aktakuzës eliminon bazën juridike për vazhdim të gjykimit², u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Konform nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.822/21, me datë 19.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

¹ Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

² *Nemo iudex sine actore.*